



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance

Thesari/Trezor/Treasury

TË DHËNAT TRE-MUJORE MBI BORXHIN E PËRGJITHSHËM

Mars 2014

Përmbajtja

SHKURTESAT	3
BORXHI I PËRGJITHSHËM	4
Portofoli i borxhit sipas valutës.....	5
Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit	5
BORXHI I JASHTËM	6
BORXHI I BRENDSHËM	7
INDIKATORËT E RREZIKUT	7

SHKURTESAT

BPV	- Bruto Produkti Vendor
FMN	- Fondi Monetar Ndërkombëtar
IBRD	- Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
IDA	- Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
KfW	- Banka Zhvillimore në kuadër të Republikës Federale të Gjermanisë
SDR	- Të Drejtat Speciale për Tërheqje
TM	- Tre-mujor

BORXHI I PËRGJITHSHËM

Duke u bazuar në Ligjin për Borxhet Publike nr. 03/L-175 dhe Rregulloren QRK mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale Nr. 22/2013, Thesari publikon raportin *Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm*.

Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet me Ligjin për Borxhin Publik si, tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal.


Në fund të muajit mars 2014 stoku i borxhit të përgjithshëm shënoi shumën 507.1 milion Euro apo 9.2% e BPV-së, nga të cilat borxh i jashtëm 317.58 milion Euro apo 5.8% e BPV-së dhe borxhi i brendshëm 189.52 milion Euro apo 3.4% e BPV-së. Stoku i borxhit të përgjithshëm është në formë të Borxhit Shtetëror dhe të Nën-huazuar, pasi që Republika e Kosovës akoma nuk ka borxh komunal dhe nuk ka emetuar garanci shtetërore. Në tabelën 1 shihet borxhi i përgjithshëm, i ndarë sipas llojit.

Tabela 1. Borxhi i Përgjithshëm (shumat janë në miliona euro)

	2009	2010	2011	2012	2013	TM1 2014
Borxhi i Jashtëm	249.01	260.42	253.60	336.60	323.76	317.58
Niveli Qendror	249.01	260.42	253.55	336.46	321.73	314.38
Nën-huazimet	0.00	0.00	0.05	0.14	2.03	3.20
Garancionet Shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51	189.52
Niveli Qendror	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51	189.52
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	249.01	260.42	253.60	409.92	476.27	507.10
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)	6.37%	6.22%	5.51%	8.44%	9.10%	9.20%

Krahasuar me vitin 2013 borxhi i përgjithshëm në tremujorin e parë të 2014 është rritur për 6.5%, kjo kryesisht si rrjedhojë e emetimit të 37.2 milion Euro Letra me Vlerë (vlerë nominale) në tremujorin e parë të 2014. Kjo rritje mund të shihet në grafikonin 1.


Grafikoni 1. Stoku i borxhit të përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së



Portofoli i borxhit sipas valutës

Në fund të muajit mars 2014, 72.87 milion Euro apo 14.4% e portofolit të borxhit është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor, kjo pasi që kreditë e huazuara nga FMN dhe IDA janë në valutë SDR¹. Ndërsa, pjesa tjetër 85.6 % e portofolit të borxhit është në valutën Euro, siç shihet në grafikonin 2.


Grafikoni 2. Përbërja e borxhit të përgjithshëm sipas valutës



Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit

Pjesa e portofolit të borxhit e cila është e ekspozuar ndaj rrezikut të interesit përbëhet nga borxhi që i detyroheni FMN-së. Kështu në fund të tremujorit të parë të 2014, 20% e portofolit të borxhit është i ekspozuar ndaj rrezikut të interesit, si shihet më poshtë në grafikonin 3.

Grafikoni 3. Përbërja e borxhit të përgjithshëm sipas llojit të interesit




¹ SDR është një 'tufë' monedhash e cila përbëhet nga monedhat e mëposhtme: EUR, USD, GBP, dhe JPY. Vlera e SDR përcaktohet në bazë të një mesatare e cila është tërhequr nga vlerat e monedhave të përmendura më lart.

BORXHI I JASHTËM


Në fund të tremujorit të parë të vitit 2014 borxhi i jashtëm ishte 317.44 milion Euro, që njëherazi përbën 62.6% të portofolit të borxhit. Krahasuar me vitin 2013 borxhi i jashtëm është zvogëluar si pasojë e kthimeve të kryegjësë për kredinë e IBRD-së dhe FMN-së. Për më shumë pjesa më e madhe e borxhit vazhdon të jetë ndaj IBRD-së, ndërsa pjesa tjetër e konsiderueshme është borxh ndaj FMN-së. Në grafikoni 4 shihet përbërja e borxhit të jashtëm sipas kreditorëve.

Grafikoni 4. Borxhi i jashtëm i ndarë sipas kreditorëve



Në fund të tremujorit të parë të vitit 2014, pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm ishte kryesisht në valutën Euro, kurse pjesa tjetër në SDR. Kryesisht kreditë e huazuara nga IDA dhe FMN janë në valutën SDR, kurse kreditë nga IBRD dhe KfW² janë në valutën Euro.

Grafikoni 5. Borxhi i jashtëm sipas valutës




² Kreditanstalt für Wiederaufbau

BORXHI I BRENDSHËM

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2014 borxhi i brendshëm ishte në shumën 189.52 milion euro apo 37.4% e portofolit të borxhit. Më poshtë në grafikoni 6 shihet kompozimi i borxhit të brendshëm sipas instrumentit.

Grafikoni 6. Borxhi i brendshëm i ndarë sipas llojit të instrumentit



INDIKATORËT E RREZIKUT

Në fund të tremujorit të parë, disa prej indikatorëve të portofolit të borxhit kanë pasur ndryshime në krahasim me vitin 2013, si shihen në tabelën 2. Indikator i Borxhi i përgjithshëm/BPV ka pësuar ndryshim të lehtë. Ndërsa, koha mesatare deri në maturim e portofolit të borxhit është zvogëluar nga 9.24 në 8.48 vite si rrjedhim i emetimeve të Letrave me Vlerë me maturitet me të vogël se 2 vite. Këto emetime gjithashtu kanë ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së borxhit të brendshëm në borxhin e përgjithshëm, e që mund të shihet në tabelën 2.

Tabela 2. Indikatorët e rrezikut

	2012	2013	TM1 2014
Borxhi i përgjithshëm/BPV	8.44%	9.1	9.2
<i>Borxhi i Jashtëm</i>	6.93%	6.2%	5.8%
<i>Borxhi i Brendshëm</i>	1.51%	2.9%	3.4%
Koha mesatare deri në maturim për borxhin e përgjithshëm (vite)	11.51	9.24	8.48
<i>Borxhi i Jashtëm (vite)</i>	14	13.42	13.28
<i>Borxhi i Brendshëm (muaj)</i>	1.53	4.28	5.77
% e Borxhit të Përgjithshëm	100%	100%	100%
<i>Borxhi i Jashtëm</i>	82.12%	68%	63%
<i>Borxhi i Brendshëm</i>	17.88%	32%	37%